




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality Gjilan
Gilan Belediye

Komuna e Gjilanit, bazuar në mandatin e sajë ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-034 si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 7 të Ligjit 04/L-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 01/12 janar 2012), shpallë:

NJOFTIM PUBLIK

PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

Njoftohen të gjithë bartësit e së drejtës banesore se me Ligjin 04/L-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike, për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarja e së drejtës banesore.

Komuna e Gjilanit, njofton bartësit e së drejtës banesore të cilët të drejtën e banimit (shfrytëzimit dhe/ose kontraktimit) e kanë fituar nga Komuna se, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë me shkrim për blerjen e banesës në afat prej dy 2 (dy) vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-061, Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 01/12 janar 2012).

Bashkë me kërkesën për blerjen e banesës, secili parashtrues duhet të bashkëngjis (dorëzoj) dokumentacionin e nevojshëm në origjinal ose kopje të vërtetuar, me të cilin vërtetohet e drejta banesore.

Kërkesat e kompletuara dorëzohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Gjilan nëpërmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, Rruga "Bulevardi I Pavarësisë" Soliteri 60.000, Gjilan.

Kërkesa për blerjen e banesës (formulari) mund të merret në Qendrën Për shërbime me Qytetarë.

Komisioni i themeluar enkas nga Kryetari i Komunës për çështjet banesore është në dispozicion të të gjithë qytetarëve.

Gjilan, 20.09.2012